

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1587 prot.

Shkodër, më 26.07.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacioni.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin për : “DHËNIE PËLQIMI PËR PRANIMIN E SPONSORIZIMIT NGA SUBJEKTI ‘RAIFFEISEN INVEST’, SH.A NË CILËSINË E SPONSORIZUESIT PËR INVESTIM DHE ZBATIM NË KUADËR TË “RIKUALIFIKIMIT TË HYRJEVE SË DISA SHKOLLAVE TE QYTETIT, SHKODËR”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Omid BEJLERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____ .07.2024
PËR

**“DHËNIE PËLQIMI PËR PRANIMIN E SPONSORIZIMIT NGA SUBJEKTI
‘RAIFFEISEN INVEST’, Sh.A NË CILËSINË E SPONSORIZUESIT PËR INVESTIM
DHE ZBATIM NË KUADËR TË “RIKUALIFIKIMIT TË HYRJEVE SË DISA
SHKOLLAVE TE QYTETIT, SHKODËR”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, nenit 23 pika 4, pika 14 të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshur; nenit 20 të ligjit nr.68/2017 “Pwr financat e vetwqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar; ligjitnr.10296, datë 8.7.20140 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, VKM nr. 366, datë 27.03.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës”; Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së pëlqimit për pranimin e sponsorizimit nga subjekti ‘Raiffeisen Invest’, sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investim dhe zbatim në kuadër të “Rikualifikimit të hyrjeve së disa shkollave të qytetit, Shkodër”, në vlerën 4,160,000 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë .
2. Vlera e sponsorizimit 4,160,000 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, hyn në buxhetin e bashkisë jo si vlerë financiare por si investim në regjistrat kontabël të aseteve të bashkisë (Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike) pas kryerjes se investimeve dhe marrjes ne dorezim.
3. Autorizohet Kryetari Bashkisë Shkodër të ndjekë procedurat vijuese, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe nënshkrimin e kontratës së sponsorizimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR


Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIM
ZV/KRYETAR
Onid BEJLERI**


Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe
Kontrollit të Territorit

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit

Financiar




Drejtoria e Përgjithshme Juridike Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse




Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.


Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të
Territorit



Drejtoria e Financës



Drejtoria Juridike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODER

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

Lënda: Relacion mbi projekt-vendimin për “Dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga subjekti ‘Raiffeisen invest’, sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investim dhe zbatim në kuadër të “Rikualifikimit të hyrjeve së disa shkollave të qytetit, Shkodër”.

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkodër, ka në pronësi sipas VKM nr.366, datë 27.03.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës”, pasuritë rrugë, trotuare dhe shesheve publike, të cilat sipas listës së inventarit të pronave, kanë fushë përdorimi: infrastrukturë rrugore.

Në kuadër të funksioneve të Njësisë së Qeverisjes Vendore, referuar ligjit 139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ , i ndryshuar bashkia Shkodër ndër të tjera ka detyrë funksionale dhe ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor të trotuareve dhe shesheve publike vendore. Subjekti ‘Raiffeisen invest’,sh.a ka shprehur interesin për ofrimin e sponsorizimit për investim dhe zbatim në kuadër të **“Rikualifikimit të hyrjeve së disa shkollave të qytetit, Shkodër”**, në shumën 4,160,000 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Kjo vlerë përfshin projektim dhe investim.

Sipas vlerësimit/projekt idesë tonë nepërmjet këtij sponsorizimi realizojmë :

Sistemimin e hyrjeve të disa shkollave, pjesa urbane ku përfshihet nderhyrje për rehabilitim të rrugës për rritjen e sigurisë së nxenesve kjo shoqëruar me sinjalistike vertikale dhe horizontale, vendosje të kufizuesve të rrugës , ku do të kalojnë femijet , shtrimi do të bëhet me shtresa me ngjyra në mënyrë që të jenë të dukshme dhe atraktive për femijet. Kjo do të shoqërohet edhe me sinjalistike për personat me aftësi ndryshe.

Kjo vlerë e sponsorizimit hyn në buxhetin e bashkisë jo si vlerë financiare por si investim në regjistrat kontabël të aseteve të bashkisë (Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike) pas kryerjes së investimeve dhe marrjes në dorezim.

Referuar propozimit të Raiffeisen invest’,sh.a sponsorizuesi do të zbatojë projektin përkatës, cili paraprakisht do të miratohet nga bashkia Shkodër.

Gjatë realizimit të investimit bashkia Shkodër do të ndjek zbatimin dhe në vijim do të plotësojë deklaratat teknike përkatëse .

Në përfundim të realizimit të investimit bashkia Shkodër proçedon me marrjen në dorëzim të investimit , regjistrimin në regjistrat kontabel të aseteve të bashkisë dhe kalimin kapital në Ndërmarrjen e Shërbimeve dhe Punëve Publike, sipas llojit të investimit.

Për sa u trajtua më sipër, në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, nenit 23 pika 4, pika 14 të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshur; nenit 20 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.7.2014 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, VKM nr.366, datë 27.03.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës”, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar,

Kërkojmë nga ana e Këshillit të Bashkisë Shkodër **“Dhënien pëlqimit për pranimin e sponsorizimit nga subjekti ‘Raiffeisen invest’, sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investim dhe zbatim në kuadër të “Rikualifikimit të hyrjeve së disa shkollave të qytetit, Shkodër”.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Onid BEJLERI